



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni Pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-013
Prishtinë, më 23 shkurt 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 SHKURT 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 16 shkurt,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 16 shkurt

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 shkurt 2015.

* * *

Kryetari më pas i njoftoi anëtarët e Kryesisë se në rend të ditës për seancën plenare të radhës do të jetë edhe Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kryesia, pasi u njoftua lidhur me çështjen e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 26 shkurt 2015, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e (3) tre anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP VV, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP Lista serbe, 1 anëtar; GP "Nisma", 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 26 shkurt 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Propozimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,

5. Propozimi për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
6. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e (3) tre anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Rekomandimi i Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që t'i shqyrtojë rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike në aspektin e implikimeve buxhetore dhe të paraqesë raport me rekomandime lidhur me të.

2. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës për mbajtjen e një seance të përbashkët me gratë deputete nga Shqipëria, Maqedonia, si dhe politikanet nga Presheva dhe Mali i Zi

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa e Grupit të Grave Deputete për mbajtjen e një seance të përbashkët me gratë deputete nga Shqipëria, Maqedonia, si dhe politikanet nga Presheva dhe Mali i Zi, me rastin e 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

2. Të gjitha shpenzimet për organizimin e lartshënuar në pikën (1) një të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Kërkesa për propozimin dhe aprovimin e përfaqësuesit të Kuvendit të Kosovës për pjesëmarrje në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore në Bullgari prej 20 deri me 21 mars 2015

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutoi Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, diskutimi i të cili është dhënë në transkript.

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, caktohet të marrë pjesë në punimet e Komisionit të Përgjithshëm për Ekonomi, Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, si dhe zyrtarja nga Administrata e Kuvendit, Merita Drenori, që do të mbahen në Bullgari, prej 20-21 mars 2015.

2. Shpenzimet e qëndrimit në hotel për të lartpërmendurit në pikën (1) një të këtij vendimi mbulohen nga organizatori - Parlamenti Nacional i Bullgarisë, ndërsa

shpenzimet e transportit, ushqimit, mëditjet, si dhe shpenzimet e akomodimit për një vozitës të Kuvendit mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pikat shitesë:

1. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes në takimin e dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit në Bruksel

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, z. Zenun Pajaziti, për të marrë pjesë në takimin e dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit, që organizohet nga Komisioni Evropian në Bruksel, prej 9-12 mars 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e kësaj vizite zyrtare, si dhe tejkalimi në rast të shpenzimeve për akomodim për të lartshënuarin në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Kërkesa për lejimin e pjesëmarrjes në Seminarin e 88-të të Rose Roth, i cili do të mbahet në Beograd

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, vendosi që nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Jasmina Zhivković, të marrin pjesë në Seminarin e 88-të të Rose Roth, i cili do të mbahet në Beograd, prej 30 mars-3 prill 2015.

Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për çështje plenare dhe procedurale